

RAPORTI TEKNIK

OBJEKTI : "HARTIM I PROJEKTIT PER PUNIME NDERTIMORE"

"Novatech Studio"shpk

INFORMACION I PERGJITHSHEM



- Hyrje

Shtypshkronja e Letrave me Vlerë sh.a. kerkon te realizoje projektin e zbatimit per projektin me objekt : “Hartim i projektit për punime ndërtimore”. Realizimi i ketij projekti ka si qellim ndërhyrje te cilat synojnë përmirësimin e kushteve të punës, rritjen e sigurisë, si dhe garantimin e funksionalitetit afatgjatë të ambienteve ekzistuese.

Objekti ndodhet ne Rruga “Xhanfize Keko”, ish-Tipografia Ushtarake, Tiranë

Vendodhja e objektit





GJENDJA EKZISTUESE

Nga verifikimet paraprake rezulton se ambientet e prodhimit paraqesin amortizim të konsiderueshëm në elementë të caktuar ndërtimorë dhe funksionalë. Konkretisht konstatohet mungesa e një hapësire të dedikuar për ngrënie për punonjësit, amortizimi i dyerve të brendshme të prodhimit, degradimi dhe nivelimi jo i rregullt i dysHEMEVE .

Ndërhyrjet e planifikuara nuk ndryshojnë strukturën mbajtëse të objektit, por përbëjnë rikualifikim funksional dhe teknik të ambienteve ekzistuese.







Foto gjendja ekzistuese








PROJEKTI ARKITEKTONIK

Nga gjendja që ka ndertesa dhe nga kërkesat e Autoritetit kontraktor është parashikuar shtrimi me resine poliretanike me dy shtresa i ambientit të prodhimit si dhe nderhyrje në ambientin e mences ku është parashikuar suvatimi i mureve të brendshme, shtrimi me pllaka grez importi, 40x40cm në ambientet e përbashkëta, veshje me pllaka tualetet e mences si dhe vendosje dritare d/alumini plastike me dopio xham dhe dyer të brendshme tamburate të rimesuara dhe dyer metalike. Gjithashtu është parashikuar sistemimi i jashtëm me shtrese çakelli mbeturine kave $t=15\text{cm}$, përhapur e ngjeshur me makineri si dhe shtrese stabilizanti $t=5\text{cm}$.





Ne projekt eshte parashikuar suvatim fasade si dhe veshje me pllaka qeramike.



Hidroizolimi i taraces se menses .

VIZATIMET GRAFIKE

Të gjithë vizatimet e projektit janë hartuar në përputhje të plotë me kushtet teknike të projektimit dhe zbatimit të vendit tonë . Ato janë punuar me kompjuter dhe janë plotësisht të dukshme.

Per pregatitjen e preventivit jane perdorur cmimet e manualit te ndertimit ne zbatim te VKM nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve” .

**PËR “Novatech Studio” SH.P.K.
ADMINISTRATORI**

Ing. Emil Nova